



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:199694
Datë: 21.08.2024
Numri i dokumentit: 06070965

P.nr.258/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Mersiha Čalaković Pllana, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit: O.A, për shkak të veprës penale: Mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 të Kodit (Nr. 06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1182/24, të datës 29.07.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 07.08.2024, në mungesën e palëve, Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Arjan Xhema, të dëmtuarit G.J, të pandehurit O.A dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit me shkrim, av.Shyqyri Sylja, me datë 08.08.2024 shpalli publikisht, ndërsa më datë 21.08.2024, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

O.A, me nofkën "...", nga i ati A..., e ëma A..., e vajzërisë B..., i lindur me datë, në K..., me adresë të vendbanimit në rrugën "...", nr....., K..., M... e V... dhe me vendqëndrim në S...S... /...,, B....., A..., i shkurorëzuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Në muajin mars të vitit 2023, në Mitrovicë, i pandehuri me dashje me anë të paraqitjes së rreme të fakteve dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e vë në lajthim të dëmtuarin G.J dhe me këtë e nxit të kryej një veprim i cili ka rezultuar me dëm material të pasurisë së tij, në atë mënyrë që i pandehuri pasi që i thotë se mund t'ia rregullojë vizën e

punës për në Kroaci përmes firmës “.....”, ashtu që fillimisht përmes Western Union pranon nga i dëmtuari shumën e parave prej 1,500 €, pastaj shumën prej 3,000 € ja jep në dorë, ashtu që i pandehuri e telefonon dhe i thotë se viza është në rregull dhe mund të shkoj ta tërheq, po që asnjëherë këtë vizë nuk e kishte marrë dhe nga data 30.09.2024 asnjëherë nuk ju është përgjigjur i pandehuri, me të cilat veprime të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 4,500 €.

- Me këtë ka kryer veprën penale: Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 79 dhe neni 323 par.1 të KPRK-së, si dhe neni 358, 364, 449 dhe 462 të KPP-së, i:

S H Q I P T O N

- I.** DËNIM ME GJOBË në shumën prej 300 (treqind) euro, i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të neni 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- II.** DËNIM ME BURGIM të kushtëzuar në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese prej një (1) viti.
- III.** NDËRPRITET MASA E PARABURGIMIT dhe i njëjti lëshohet në liri nga sot, datë 08.08.2024.
- IV.** Të pandehurit O.A, koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 14.07.2024 e deri me datë 08.08.2024 i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim të kushtëzuar.
- V.** Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

VI. I dëmtuari G.J, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m i

Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1182/24, të datës 29.07.2024, ndaj të pandehurit O.A, për shkak të veprës penale: Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Me datë 07.08.2024, Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Arjan Xhema, të dëmtuarit G.J, të pandehurit O.A dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit me shkrim, av.Shyqyri Sylja.

I pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga Gjykata, me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale, është deklaruar dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së Prokurorisë. Ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur dhe i premtoi Gjykatës se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, po ashtu shtoi se paratë e marra ia ka kthyer të dëmtuarit.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i propozoi Gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore dhe se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Kërkoi që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

I dëmtuari G.J, propozoi që të miratohet pranimi i fajësisë, duke shtuar se paratë i janë kthyer nga i pandehuri dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Mbrojtësi i të pandehurit O.A, av.Shyqyri Sylja, propozoi që të miratohet pranimi i fajësisë, pasi që një pranim i tillë është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me të si mbrojtës dhe është në përputhje me provat e përfshira në aktakuzë. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, propozoi që si rrethanë lehtësuese të merret fakti se i pandehuri është i moshuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka qenë hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, pranimin e fajësisë, dëmshpërblimin të dëmtuarit, pendimin e thellë dhe premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Gjetjet e Gjykatës:

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri O.A, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimin të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarit – dëshmitarit G.J në SP Mitrovicë Jugu, i datës 27.10.2023; Dhjetë fotografit nga ku shihen bisedat e zhvilluara në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit në rrjetin social “Messenger”; Dëshmi e pagesës nga i dëmtuarit në Wester Union, e datës 01.03.2023; Raporti i oficerit i datës 27.10.2023; Procesverbali mbi intersistimin e të pandehurit në SP Mitrovicë Jugu, i datës 27.10.2023 dhe marrja e deklaratës së të pandehurit në PTH Mitrovicë, e datës 25.07.2024; si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale: Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimin të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri O.A është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilat akuzohet: Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin O.A, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese ka vlerësuar, shkallën e përgjegjësisë penale, pra dashjen në kryerjen e veprës penale,

përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në veprën penale, ndërsa rrethana tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, pendimin e thellë për veprimet e kryera, keqardhjen e shprehur nga i pandehuri në seancë gjyqësore dhe premtimin e dhënë se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, sjelljen e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që ka qenë hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe që nga kryerja e kësaj vepre penale më nuk ka ndërmarrë veprime ne kryerjen e çfarëdo natyre të veprave penale, faktin se parat ia ka kthyer të dëmtuarit dhe gjithashtu rrethanë tjetër lehtësuese Gjykata mori rrethanat e tij personale, i njëjti është i moshuar, person familjar, baba i gjashtë fëmijëve. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti.

Gjykata, në kuptim të nenit 48 e 49 të KPRK-së, ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim me kusht si në dispozitiv, pasi janë plotësuar kushtet në tërësi për shqiptimin e këtij dënimi. Kjo për faktin se vepra për të cilën është shpallur fajtor dënohet deri në pesë vjet, e që në kuptim të par.1 të nenit 49 të KPRK-së, dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilin është paraparë dënimi deri në 5 vjet. E po ashtu është plotësuar edhe kushti që ky dënim mund të shqiptohet nëse Gjykata ka shqiptuar dënim deri në 2 vjet me burg, për çka në rastin konkret, të pandehurit i është shqiptuar dënimi me burgim të kushtëzuar prej 6 muajve.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, Gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë dhe me burgim, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38, par.1 dhe neni 47 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, Gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballeshëm për kushtet ekonomike të tij.

Ndërprerja e masës së paraburgimit:

Gjykata, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që të pandehurit ia ka ndërprerë masën e paraburgimit, me rastin e shpalljes së aktgjykimit. Në lidhje me këtë, Gjykata ka lëshuar vendim të veçantë ku edhe i ka dhënë arsyet për një vendim të tillë. Po ashtu të pandehurit kohën e kaluar në masën e paraburgimit nga data 14.07.2024 e deri me datë 08.08.2024, ia ka llogaritur në dënim e shqiptuar me burgim të kushtëzuar. Kjo duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së, ku përcaktohet se koha e kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata, ka vendosur si në pikën VI të dispozitivit të aktgjykimit bazuar në nenin 462 të KPP-së, të dëmtuarin e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449 dhe 462 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.258/2024, datë 21.08.2024

Bashkëpunëtore Profesionale:

Edita Koliqi

Gjyqtarja:

Mersiha Čalaković Pllana

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.